



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, datë 18.03.2020

NJOFTIM

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën më dije opinionin publik se, në zbatim të Aktit normativ të Këshillit të Ministrave nr.3, datë 15.03.2020, “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, si dhe sipas protokollit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, ka ndërrmarë të gjitha masat për vazhdimësinë e proceseve administrative institucionale.

Me urdhër të Drejtores së Përgjithshme të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural do të vazhdojnë proceset e shqyrtimit të dosjeve, kontrollet apo verifikimet në terren për subjektet e kontraktuara, si dhe marrja e kërkesë pagesave në kuadër të programit IPARD II, financuar nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Shqiptare.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton grupet e interesit se, dokumentacioni plotësues i aplikantëve, si dhe kërkesa për pagesë për ndihmën publike në lidhje me projektin e financuar, mund të dorëzohet në zyrën e protokollit të “Agjencisë së Pagesave”, por duke parë situatën e krijuar, këshillojmë dërgimin e dokumentacioneve përmes shërbimit postar (duke ruajtur fletë-pagesën, e cila dëshmon dërgimin) në adresën e mëposhtme:

Agjencia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Rruga Muhamet Gjollesha Nr.56

1001 Tiranë, Shqipëri